

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mbikëqyrje punimesh per objektin : “ Ndërtim puse dublikant, rrethim dhe pastrim te puseve ekzistuese, Burimi Popojve, Harizaj, Shtordhër dhe Synej, Bashkia Kavajë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 71247000-1 Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,366,790.88 (Një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtaqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e tetë) leke pa tvsh.

Referuar nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKDurrës sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Afati i realizimit të mbikqyrjes së punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet.

Argumentim:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt: **Supervizion Ndërtim puse dublikant, rrethim dhe pastrim te puseve ekzistuese, Burimi Popojve, Harizaj, Shtordhër dhe Synej, Bashkia Kavajë ”.**

Mbështetur në Seksioni III “VEPRA INXHINIERIKE”

“Tabela shoqëruese e tarifave -”, GRUPI TARIFOR III

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit (shtojca 10)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenet 43 dhe të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, gjithashtu, bazuar dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29. 12. 2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit ne raport me perqindjen qe ka ne kete bashkim operatorësh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mbi bazën e të cilave, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi “ të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, me anë dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) Shërbime të mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) Shërbime të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të leshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e shërbimit të realizuar.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e shërbimit të realizuar, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: *Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:*

Shërbime të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shërbime të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kopetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

a) Operatori ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

-Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- **Kategoria NP- 1** (Punime germimi ne toke) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime germimi.
- **Kategori NP -7** (Ujësjellës, kanalizime , vepra kullimi dhe vaditje) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit mund të kemi riparime ose zëvendësim të ndonjë tubacioni,saracineske apo rakorderie të tubacioneve të ujësjellësit.

-Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- **Kategoria NS-1**(Punime per prishjen e ndertimeve) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime prishje te objekteve ekzistuese qe përfshihen ne zonene e projektit.
- **Kategoria NS-4** (Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime rifiniture te muratures qe përfshihen ne zonene e projektit.
- **Kategoria NS-20** (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje) kërkohet sepse gjatë implementimit të projektit kemi punime puse shpime per uje.
- Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.
- Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues .
- (Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

b) Operatori ekonomikë duhet të disponojë licence mbikeqyrjesipas rregullores se miratuar ne VKM Nr.943 date 28/12/2024 “Per procedurat e dhenies se licencave profesionale per individe dhe persona juridike ne fushen e studim projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrje e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim”

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet te dorezoje licencat profesionale sipas zerave te preventivit qe ne baze te marreveshjes se bashkepunimit merr persiper te realizoje.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **Per realizimin e sherbimit te mbikeqyrjes**

- | | |
|-------------------------|---------|
| • Inxhinier Gjeolog | 2 (dy) |
| • Inxhinier Hidroteknik | 2 (dy) |
| • Inxhinier Elektrik | 2 (dy) |
| • Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |

Për stafin e sipërcituar OE duhet të paraqesi: -

Diplomen,

-Licenca Profesionale,

-kontratat individuale te punes sipas legjislacionit ne fuqi

-Liçensën individuale të mbikëqyrjes si dhe:

-duhet të jenë të te siguruar për të paktën **muajin e fundit** dhe të figurojnë në listëpagesat E-Sig të OE.

-Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 10, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 7 punonjës të pasqyruar në listëpagesa për muajin e fundit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- Certifikate ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente (e vlefshme) objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit”ose ekuivalente (e vlefshme) objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikate ISO 45001-2018 “Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune” ose ekuivalente (e vlefshme) objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim EN-ISO 3834-2:2021 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën EN-ISO 3834-2:2021

Shënim: Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është ,lënë në dispozicion për realizimin e kontratës nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, kontrate mbikeqyrje që lidhet me kohën e zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Argumentimi: Në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike: janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij, duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre. Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.